



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 622 Prot

Tiranë, më 04.02 2020

UDHËZIM

Nr. 61 Datë 04.02 2020

PËR
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 481, DATË 27.06.2019 “PËR PROCEDURAT
E PUNËSIMIT PËR PROFESIONET E SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin Nr. 27/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 481, datë 27.06.2019 “Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 në Kreun 7, të udhëzimit nr. 481, datë 27.06.2019, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:
“1.Të gjithë studentët e ekselencës që aplikojnë në portalin “Infermier për Shqipërinë”, marrin një bonus deri në 10 pikë shtesë në llogaritjen e pikëve për vlerësimin e dosjes. “Studentë të ekselencës”, në kuptim të këtij udhëzimi, janë studentët të cilët kanë përfunduar studime universitare në nivelin bachelor me mesatare mbi 9.00 - 10 ose ekuivalent, jo më herët se 3 (tre) vite përpara vitit kalendarik për të cilin po zhvillohet procedura.
2. Pika 2 e shtojcës nr. 3 të udhëzimit, ndryshon sipas përmbajtjes më poshtë:
“2.Studentë ekselent të tre viteve të fundit u shtohen deri në dhjetë pikë shtesë (pa tejkalluar 30 pikë gjithsej për vlerësimin e dosjes), të llogarituara si më poshtë:

Nota mesatare 9	0 pikë
Nota mesatare 9.1	1 pikë
Nota mesatare 9.2	2 pikë
Nota mesatare 9.3	3 pikë
Nota mesatare 9.4	4 pikë
Nota mesatare 9.5	5 pikë
Nota mesatare 9.6	6 pikë
Nota mesatare 9.7	7 pikë
Nota mesatare 9.8	8 pikë

Nota mesatare 9.9 9 pikë
Nota mesatare 10 10 pikë

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

